



Shkolla Verore e OSMANISHTES

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike – Dega e Gjuhës Turke në kuadër të promovimit të programeve mësimore të Degës së Gjuhës Turke dhe për t'i ardhur në ndihmë studentëve të turqishtës e më gjerë, do të organizojë për të katërtin vit radhazi “*Shkollën verore të osmanishtes*” në bashkëpunim me Universitetin Aydın të Stambollit, Universitetin Bartin të Turqisë - Departamenti Dialekteve Turke me të cilin universiteti ynë ka marrëveshje Erasmus +.

Do të formohen dy grupe, në nivel fillestarë dhe në nivel të avancuar në osmanisht, me një numër të përgjithshëm rreth 20 studentë. Kursi do të zgjasë nga **28 qershor** deri më **9 korrik 2021**.

Në përfundim të kursit studentët dhe pedagogët e angazhuar do të pajisen me një certifikatë pjesëmarrjeje.